



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 254/3 Prot.

Tiranë, më 19.03. 2024

**V E N D I M**

**Nr.69, Datë 19. 03. 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr.17 Regj, datë 07.02.2024, të paraqitur nga ankuesja znj. E. K, kundër Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës, në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja znj.E. K, ndër të tjera parashtron se, është pedagoge me titull Doktor pranë Departamentit të Prodhim Manaxhimit (DPM) në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM), Universiteti Politeknik i Tiranës që prej vitit 2008.

Udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) si dhe në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 59, pika 8, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Arsimit dhe Sportit, detyron drejtuesit e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të veprojnë konform tij në mënyrë të barabartë, jo selektive dhe jo diskriminuese. Në të vërtetë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike pas zgjedhjeve të vitit 2020 unë jam ndjerë e diskriminuar dhe në fokusin e luftës nga Dekani i FIM, i mbështetur edhe nga Rektorati UPT, si linja e pushtetit që ka fokus të luftojë personelin që për ta "nuk ka votuar".

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Goditja e figurës sime u tentua me shumë mënyra mashtruese dhe situata problematike me probleme të nxitura artificialisht.

Mbas shumë peripecive që më është dashur të përballoj, si ndryshime të paligjshme ngarkese nëpërmjet falsifikimit të orarit (të pabazuara në ngarkesën e marrë nga departamenti), ankimim në komision të etikës ku unë fitova me rezultatin 8 me 2, Dekani i Fakultetit të FIM z. G. G, në tejkallim të kompetencave doli me një urdhër të paligjshëm datë 29.03.2022 me Nr. Prot., 224 për të grabitur ngarkesën time mësimore, të cilën e kam zhvilluar prej dy dekadash.

Ndërkohë, si pasojë e këtij urdhëri, është shkruar "Grupi Mësimor i Grafikës Inxhinierike" dhe janë kryer lëvizjet e personelit akademik midis departamenteve, si më poshtë:

- Grupi mësimor i Grafikës Inxhinierike u shkri me Urdhërin e Dekanit datë 29.03.2002, urdhër i pakonsultuar me pedagogë antarë të grupit mësimor dhe departamenteve ku u shpërndanë këta anëtarë, në shkelje të ligjit nr.80/2015, Statutit dhe rregullores së FIM.

- Nëpërmjet këtij urdhëri Dekani z. G, ju caktoi pedagogëve të grupit mësimor, departamentet ku do të atashoheshin dhe degët ku do të zhvillonin aktivitetin mësimor, pa përfillur rregulloren, lirinë akademike, eksperiencën apo përkatësinë në fushat e tyre të kërkimit shkencor.

- ✓ A. N - ndryshim departamenti dhe heqje ngarkese për të cilën ka kontribuar në më shumë se dy dekada, pa konsultim dhe aprovim personal dhe të departamentit përgjegjës DPM.
- ✓ E. K - heqje ngarkese për të cilën ka kontribuar në më shumë se një dekadë, pa konsultim dhe aprovim personal dhe të departamentit përgjegjës DPM.
- ✓ M. Z - heqje ngarkese për të cilën ka kontribuar në më shumë se një dekadë, pa konsultim dhe aprovim personal dhe të departamentit përgjegjës

Të bindur që Dekani z. G. G me këtë urdhër ka tejkalluar kompetencat institucionale deri në abuzim me detyrën, ne pedagogët e cënuar nga ky udhër, E. K, A. N dhe M. Z (3 pedagogë nga 5 total antarë të grupit mësimor të GI) e kemi kundërshtuar që në fillim. Kjo është arsyeja që kemi ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Shkresë drejtuar Rektorit datë 20.04.2022 në të cilin kemi kundërshtuar këtë urdhër dhe kërkonim moslejimin e zbatimit të kësaj paligjshmërie. Në këtë shkresë do të gjeni të detajuara shkeljet e sipërpërmendura . -Shkresë e mbetur pa përgjigje.

- Shkresë drejtuar Rektorit datë 13.05.2022. Shkresë e mbetur pa përgjigje.

- Shkresë drejtuar Rektorit datë 08.09.2022. Shkresë e mbetur pa përgjigje.

- Shkresë drejtuar Drejtuesit të Departamentit datë 28.09.2022 ku ne pedagogët kundërshtojmë shpërndarjen e urdhëruar të ngarkesës nga Dekani z. G. G.

- Email drejtuar senatit për dijeni në datë 08.05.2023.

Në dijenin tonë, Rektori në bashkëpunim me zyrën juridike pranë rektoratit, e kanë për detyrim ligjor të shprehen për interpretimin e ligjshmërisë së këtij urdhëri, dhe në kushtet ku një interpretim i tillë nuk erdhi kurrë, e paditëm urdhërin në gjykatë, dhe aktualisht jemi në proces gjyqësor.

Në vazhdim të këtij skenari "Dekanati" mbas grabitjes së ngarkesës mësimore të caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit dhe unë e realizoja për më shumë së dy dekada vazhdoi me mospagimin e orëve suplementare të realizuara në auditor.

Për më tepër diskriminimi ndaj personit tim vazhdon!! Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në mënyrë selektive janë kryer pagesat e orëve suplementare në auditor, në periudhën kohore tetor-nëntor 2023, ndërsa mua më është mohuar kjo e drejtë në mënyrë diskriminuese, poshtëruese dhe fyese për integritetin personal, intelektual duke cënuar rëndë lirinë time akademike.

Konkretisht Dekani z. Genti Guxho, dërgoi me email të datës 08.11.2023, një Raport Konstatimi, të bazuar mbi Deklarimin Paraprak të Realizimit të Ngarkesës që unë kisha dorëzuar, tek i cili deklarohet një parashikim paraprak i aktiviteteve mësimore dhe shkencore.

Në datë 14.11.2023 i dërgoj email për Deklarimin Përfundimtar të Realizimit të Ngarkesës, duke i kërkuar që të zëvendësonin Deklarimin Paraprak që dekanati dispononte. Mbas kërkesës sime për tu takuar, u dakortësuam për datën 17.11.2023, takim i cili nuk u zhvillua, i anuluar nga Dekani momentin e fundit nëpërmjet sekretares, me premtimin që do më njoftonin për një takim tjetër.

Në datën 07.12.2023 duke qenë se nuk po më krijohej mundësia për një takim të drejtpërdrejtë i dërgoj email Dekanit z. G. G, për ti kërkuar në çfarë stadi ishte shqyrtimi i realizimit të ngarkesës sime.

Meqënëse këto emaile u injoruan nga dekanati, depozitoj në datën 15,12.2023 me nr.Prot., 734/1, Deklarimin Përfundimtar të Ngarkesës në mënyrë zyrtare të firmosur nga Përgjegjësi i departamentit I. B.

Përgjigja erdhi në datën 19.01.2023 me nr.Prot., 49, datë 19.01.2023, në të cilin Dekanati deklaroi në mënyrë të padrejtë që unë i kam realizuar këto zëra.

Drejtuesit e FIM, konkretisht Dekani z.G. Gu, zv.Dekanët z. A. D dhe z. Odhisea Koca, kanë mohuar në mënyrë të qëllimshme zëra të veprimtarisë sime mësimore-shkencore-profesionale-administrative etj., në çdo raport konstatimit të tyre. E gjithë kjo tendencë për të mos më paguar mbingarkesën e ka filluar në grabitjen me urdhër të paligjshëm e tani në vazhdim me sorollatjen dhe përqeshjen e tyre në lidhje me zërat e realizimit të saj.

Në takimin e realizuar në zyrën e Dekanit në datën 26.01.2024 të dy drejtuesit Dekani z. G. G, dhe Zv.Dekani z. A. D, nuk patën asnjë qasje pozitive, por më kërkuan të justifikoja shumë veprimtari që nuk iu janë kërkuar shumicës së kolegëve të mi. Gjithashtu vendosën të heqin orë të detyrave të cilat në të shkuarën janë pranuar kolegeve E. B dhe Sh. C (janë fakt ngarkesat e

fimosura nga këto kolege në dekanat). Arritën të më kërkojnë të dokumentoj edhe ekspertizën apo përhapjen e inovacionit, në një kohë që të dy artikujt shkencor që unë kam realizuar mbështeten në këtë ekspertizë.

Nëse nuk do të ishte kjo ekspertizë ku do ti gjenim të dhënat për artikuj??

Diskriminimi vazhdon.... edhe nga ana e Zv. Dekanit me anën shkencore z. O. K, i cili me qëllim e ka mbyllur laboratorin në bodrum dhe nuk më lejojnë as të hyj brenda. Unë jam njëri nga tre pedagogët që aplikuaam dhe fituaam Projektin Kombëtar në vitin 2009 për të krijuar këtë laborator.

Ju bëj me dije se, rasti im i diskriminimit nuk është i vetëm, pasi në dijenin time, janë edhe disa kolegë të tjerë që ju është mohuar e drejta dhe janë diskriminuar dhe poshtëruar në të njëjtën mënyrë. Nga bisedat e trajtuara me kolegët që e kanë marrë këtë pagesë më konfirmuan se nuk janë kërkuar dokumente justifikues apo evidenca mbështetëse për aktivitetin e tyre (1536 orë)! Përcaktimin se kush e merr pagesën e orëve suplimentare, nuk ka kriter meritokracinë dhe zbatimin e ligjit, por trajtohet dhe vendoset nga grupi i dekanatit sipas preferencave të tyre, mosbarazisë dhe interesave të tyre të ngushta!!!

Kam konstatuar se evidencat mbështetëse nuk janë kërkuar për të gjithë personelin akademik, por në mënyrë selektive vetëm për disa që nuk futen në "të preferuarit", apo "Mbështetësit e tyre në vota", ashtu siç më kanë kategorizuar, diskriminuar edhe personin tim.

Në bindjen time, ndihem e diskriminuar, e pabarabartë dhe e "sulmuar" jo vetëm nga kjo situatë e fundit e mospagesës së orëve suplimentare të realizuara, por edhe nga veprimet e tjera të paligjshme dhe nënçmuese deri tek "grabitja e ngarkesës" dhe praktika e ndjekur në drejtim të personit tim. Më kanë privuar nga e drejta ime, të drejtë që ma jep Kushtetuta, Ligji për Arsimin e Lartë, VKM, Udhëzime të dala në zbatim të tyre.

Jemi para faktit të një abuzimi të pastër me detyrën, komunikim jo etik, arrogant dhe tejkalim kompetencave të pozicionit të Dekanit të FIM.

Këto veprime arbitrare dhe diskriminuese nga ana e drejtuesve të FIM, kanë prekur rëndë, të drejtën time në thelb, jo vetëm, për grabitjen e ngarkesës por dhe të mospagesës për orët suplimentare.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri:

1. Trajtimin e rastit të diskriminimit dhe daljen me një vendim;
2. Anullimin e Urdhërit të Dekanit datë 29.03.2022, nr. Prot., 224;
3. Kthimin e ngarkesës mësimore të grabitur nga ky urdhër;
4. Ndërhyrjen për anullimin e zbatimit të një procedure antiligjore "P004";
5. Rekomandimin e masave disiplinore dhe marrjen e përgjegjësisve ligjore për z.G. G, (Dekan i FIM), z.A. D, (Zv.Dekan i FIM), z.O. K, (Zv.Dekan i FIM);

6. Verifikimi nga një grup ekspertësh nga MAS për verifikimin e çdo ngarkese të dorëzuar nga stafi akademik FIM për plotësimin e formën "P004";
7. Falje publike ndaj personit tim, dëmshpërblim dhe masë kufizuese për z.G. G, z.A. D, z.O. K për të kryer/mbajtur në vijim, funksione drejtuese në FIM.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *"Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

- *Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, ndër të tjera në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e ankuesit, në kuadër të "çdo shkak tjetër".*

Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr.254/1 prot., datë 13.02.2024, ankueses i'u kërkuar të saktësojë shkakun e pretenduar të diskriminimit në kuadër të "çdo shkak tjetër", duke përcaktuar qartësisht se cila është karakteristika apo veçantia që mbartet prej saj në cilësinë e ankueses dhe për shkak të të cilës pretendohet se ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar. Së bashku me qartësimin/saktësimin e shkakut të pretenduar të diskriminimit në kuadër të "çdo shkak tjetër" ankueses iu kërkuar të depozitonte provat mbi bazën e të cilave e bazon pretendimin e saj në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit.

Me email e datës 23.02.2024, ankuesja depozitoi pranë Komisionerit informacionin shtesë në lidhje me ankesën, duke parashtruar ndër të tjera si më poshtë vijon:

*Jam shume e nderuar dhe Ju falenderoj për marrjen në shqyrtim të ankesës sime!*

*Arsyeja e diskriminimit nga ana e Dekanit G. G, është “vota kundër” ,*

*(1) për mos mbështetjen në fushatën që ai bëri si kandidat për dekan në 2020, por mbështetjen e kandidatit kundërshtar Prof. F. B, (2) në mbledhjen e departamentit ku Z. G. G shpalli kandidaturën në bëra pyetje që e vunë në veshtirësi në syrin e kolegeve të tjerë (shpjegimet më poshtë), (3) për zgjedhjet e 2023, kam shprehur mbështetjen e kandidatit potencial që do konkurojë përballë tij në zgjedhjet e ardhshme Z. L. M, dhe mos nënshtrimi, por paditja në gjyq e tij për urdhrin e paligjshëm Urdhër Nr. 41, 29.03.2022.*

*Për të ju shpjeguar diskriminimin tim që filloi me mbarimin e zgjedhjeve në 2020 e deri më sot, po filloj me elementë narrative që do mbështeten nga dokumentacioni i atashuar. Unë kam filluar si pedagog në vitin 1998 në Katedrën e Vizatimit Teknik, katedër e cila me vonë me riorganizimin e fakultetit në departamente, u inkorporua në Departamentin Prodhim Menaxhim dhe u quajt sektor i Grafikes Inxhinierike. Mbas daljes në pension të 4 profesorëve, që gjeta si kolegë unë kam vjetërsinë me të madhe në këtë sektor. Të gjithë të tjeret kanë ardhur me vonë, megjithesë janë në moshë më të madhe së unë. Ngarkesën që kam realizuar në vite, e kam marrë në mënyrë graduale kur ngelej e lirë pas ndaljes në pension të kolegëve që gjeta në momentin që hyra si personel akademik me kohë të plotë. Ngarkesë që nuk ka pasur asnjëhere kontestim nga askush dhe që u solidifikua në vite. Z. G. G, është Inxhinier Tekstili dhe jemi të të njëjtit brez. Ai ka qenë për më shumë se 20 vjet në organet drejtuese si Përgjegjës Departamenti e Zëvendës Dekan (detyra që i ka mbajtur edhe të dyja njëkohësisht), edhe si Zëvendës Rektor. Për mendimin tim, pjesmarrja e tij në ekipin drejtues të FIM dhe UPT ka qenë e lidhur me Akademikun J. K. Kur Z. K., ka qenë dekan 2004 – 2008, Z. G. G, ka qenë zv dekan. Kur Z. K. ka qenë rektor 2008-2016 Z. G. G, ka qenë Zv.dekan dhe Zv.rektor me nga një mandat. Mbase Z. K mbaroi mandatin si rektor dhe u rizgjodh në 2016 - 2020 Dekan i FIM, Z. G. G, u rikthye prapë si Zv.Dekan, pra ishte “i perzgjedhuri”. Mbas prishjes së aleancave midis tyre, disa muaj përpara zgjedhjeve të 2020, Z. G. G, doli me tezën që korrupsioni i Z. J. K, ishte për tu dënuar dhe i pashoq, e pabesueshme për mua që i kisha parë për më shumë se 16 vitë shokë e aleatë. Po ju atashoj një pjesë të shkrimit të Z. G, në facebook para kandidimit të dokumentit në facebook: "Jemi në një fushatë zgjedhjesh e cila është stërzgjatur, për arsye objektive, fjala më e lehtë për këtë vendim është së nuk është etik. Pyetja ime është sa do të vazhdojmë me arbitraritetin? Kur do t'i kthehemi normalitetit në vendimmarrje? A do të lejojmë që një njeri i vetëm të përcaktojë pasardhësin si në mbretëritë e mesjetës? A do të përshtatim dot një model të ngritjes së institucionit mbi bazën e rregullave? Do të ndëshkojmë ata që thonë mendimin e tyre duke shfrytëzuar vulën dhe firmën?*

*Jo! Përgjigjen ky model do ta marrë me votë! FIM nuk është një organizatë e “malavita”!*

*Në 2020 Z. G. G, shpalli kandidaturën për pozicionin Dekan. Në mbledhjen e parë të fushatës ku Z.Genti Guxho na mblodhi për të shprehur kandidaturën në 2020, unë jam ngritur e para, (dëshmitarë janë të gjithë kolegët e mi), dhe e kam pyetur: “ Ju Z. G. G, keni qënë në ekipin drejtues të FIM dhe UPT për sa vitë unë ju mbaj mend të jeni pedagog e të jemi kolegë bashkëmoshatarë, si ka mundësi që ju pjesë e udhëheqjes nuk e kishit kuptuar këtë korrupsion dhe*



*drejtim të dhunshëm??? A nuk ishit edhe ju pjesë e vendimarrjes dhe favorizimeve në këto 16 vite?” Natyrisht nuk mora përgjigje, por mora etiketimin si “vota kundër”.*

*Pyetja ime në hapjen e fushatës, pëlqimi që unë kam shprehur për kandidatin kundërshtar të tij Prof. F. B, profesori im, dhe mospranimi im për të diskutuar rreth votimeve me njerzit që ai dërgonte, si Prof. A. S, çoi në etiketimin tim si “vota kundër”. Profesor A. Sh, me ka thënë: “Kështu e pëson kur nuk dëgjon çfarë të thuhet....” Z. G. G, u bë Dekan në 2020 dhe i pari vendim që mori ishte shkarkimi im nga përgjegjëse sektori dhe vendosjen e koleges Sh. C, e cila u përdor me vonë për të më grabitur ngarkesën. Unë nuk kisha lëvizur asnjëherë nga ai sektor dhe e kisha lidhur karrieren time me këtë sektor, megjithëse konsiderohet si sektor që nuk bën dot karrierë shkencore. Kolegia Sh. C, u pranua si personel akademik për të dhënë lëndën vizatim teknik disa vite mbas meje. Për më shumë se dy dekada ajo ka kërkuar në mënyrë këmbëngulëse të kalonte në sektorin e Materialeve ku kishte edhe fushën e doktoraturës, dhe ka dhënë lëndë në Masterin e Materialeve. Vetëm në 2019 ajo mori ngarkesë të plotë pranë sektorit tonë të vizatimit. Ky shkarkim u justifikua me faktin që ajo është kategoria As/prof ndërsa unë Dr, por të dyja e kishim fushën e kualifikimit të titujve jashtë sektorit të vizatimit, ndërkohë që unë kisha vjetërsi si pedagogë me të madhe së ajo, dhe kisha kontribuar pa asnjë shkëputje në këtë sektor. Gjithashtu në konkursin që u bë me pikëzim, nuk u morën parasysh çertifikimet e mia ndërkombëtare, si p.sh çertifikimi ndërkombëtar si IWE- International Welding Enginer që e fitova mbas një periudhe studimi dhe provimesh pranë IIS-Institutit Italian të Saldimit me kurorëzim në 2020 dhe titujt e tjerë europian për kontroll saldimesh. Unë e pranova dhe e urova kolegen.*

*Duhet të më kuptoni që diskriminimi i gjithë këtyre vitëve që nga 2008, për shkak të mos votimit të fituesit në drejtim me ka shtyrë që karrirën time ta bëj me marrjen e titujve ndërkombëtare dhe jo brenda fakultetit, sepse është e pamundur të mendosh që këta drejtues mund të të japin një dietë për konferencë, apo të të kalojnë një projekt kur ti je “vota kundër”.*

*Por mbas shkarkimit si shefe sektori që shoqërohet edhe me ulje rroge nuk u kënaqën, lufta e padrejtë karshi meje vazhdoi. Kolegia Sh. C, donte të jepte mësim në degët e mia, tek të cilat kisha me shumë se dy dekada që jepja mesim dhe i kisha pajisur me libra e materiale sipas programit. Dekani filloi tentativat për të më grabitur ngarkesën nëpërmjet departamentit, por pa sukses. Meqënëse nuk ja dolën, në tetor të vitit 2021 kurdisën prapaska djallëzore.*

*Dekani G. G, nëpërmjet Zv.Dekanit A. D, falsifikoi orarin dhe vuri emrin e saj në klasën time të leksionit të cilën e mora për lapsus. Djallëzia ishte të krijonin konflikt të stisur verbal midis meje dhe Zj. Sh. C, duke e futur atë në klasën time të leksionit nëpërmjet falsifikimit të orarit.*

*Përgjegjësi i Departamentit Z. I. B, në respekt të ngarkesës së miratuar në departament në tetor 2021 e nxori jashtë klasë kolegen Sh. C, dhe unë vazhdova mesimin si e kisha bërë për dy dekada. Unë kontaktova menjëherë avokatin tim, për të luftuar padrejtësinë e hapur që po me bëhej (Dokumenti 1- Email i avokat A. R drejtuar institucionit të dekanit pa përgjigje). Skenari kishte qënë djallëzor.*

*Dekani po nxiste një konfrontim verbal timin me Zj. Sh. C, para studentëve, dhe megjithëse nuk kishtë asnjë gjë të tillë nën drejtimin e Z G. G, kolegia çoi një ankesë në Këshillin e Etikës kundër meje për të më dënuar, por vendimi i Këshillit të Etikës ishte 8-2 në favorin tim (Dokumenti 2-Vendimi i Këshillit të Etikës që do jua vë në dispozicion sapo të më mundësohet marrja në zyrën e arkivës). Meqënëse edhe kjo nuk ju eci, dhe mbas kërcënimeve indirekte ata dolën me urdhër të paligjshëm deri në kufijtë e shpërdorimit të detyrës Urdhër i Dekanit Nr 41; 29 mars 2022. Shpjegimet në lidhje me këtë vendim janë të detajuara në dosjen time të mëparshme. Vendim i cili meqënëse rektorati na la në mes të rrugës, e kemi çuar në gjyq.*

*Po ju vë në dispozicion të atashuara ngarkesën time mësimore që nga viti 2018 për të evidentuar degët ku jepja dhe mund ta krahasoni ndryshimin me atë të vitit 2022-2023, ngarkesë që mu grabit dhe mu ndryshua me urdhërin në datën 29.03.24 të dekanit. Në dispozicion do keni edhe parashikimin e ngarkesës së koleges tjetër dhe tabelën e parashikimit të marrë nga drejtuesi i departamentit në 2019-2020 për të provuar që këto degë mu morën pa të drejtë. (Dokumenti 3 –*

*Ngarkesa K., Dokumenti 4 – Ngarkesa e pedagoges znj.C dhe Dokumenti 4 – Tabela e ngarkesës së Departamentit Prodhim Menaxhim) Ndëshkimi karshi meje tani ka arritur deri në mbajtjen e pagesës së mbingarkesës. Pagesë që 95% e pedagogëve e kanë marrë, ndërsa unë dhe 2-3 të tjerë nuk e kemi marrë.*

*Unë kam qenë çdo ditë në punë dhe kjo është konfirmuar nga Përgjegjesi i Departamentit nëpërmjet fletë prezencës çdo muaj. Ndërkohë e kam realizuar mbingarkesën dhe dekanati nuk e konteston. Preteksti që mbingarkesa nuk do të më paguhet, sepse unë nuk kam realizuar 1536 orëshin është pa asnjë bazë ligjore dhe përdoret vetëm në mënyre selektive në kolektivin tonë.*

*Llogaritja e 1536 orëshit, bëhet nga Dekani G. G, pa asnjë bazë ligjore apo koeficientë të standartizuar e të miratuar në organet e UPT apo Bordin e Administrimit, siç e kam shpjeguar në ankesën e parë drejtuar institucionit Tuaj. Është qesharake të thuash që një libër në çdo fushë shkencore të realizohet për 100 orë, apo një artikull shkencor të shkruhet dhe të dalësh në konkluzionë eksperimentale ose jo, për vetëm 50 orë, koeficientë që Dekani ynë i ka vendosur me një procedurë P004 të krijuar e miratuar nga ai vetë. Unë ia kam thënë përballë që kjo procedurë është shkopi i Maliqit për ata që ai do të dhunojë e intimidojë. Këtë procedurë ai e miratoi në Asamblenë e Personelit Akademik APA – që është një organ, që nuk mund të miratojë një dokument të tillë (e kam shpjeguar në ankesën që e kam dorëzuar tek Ju). Nëse mund ta përmbledh diskriminimin si “votë kundër” dhe paditja në gjyq, nga Dekani G. G, ka filluar:*

*- Nëntor - Dhjetor 2020 me shkarkimin si përgjegjëse sektori, megjithëse unë kam punuar me ndershmëri, e kam kërkuar respektimin e rregullave edhe nga kolegët si p.sh sekretimi i provimeve që të pengonim korrupsionin, por që shkaktonte pakënaqësi, etj.*

*- Janar 2021 – deri në Dhjetor 21 u krijuan konflikte të stisura në sektor që u kulmuan me paditjen në Këshillin e Etikës që me shkatoi një lodhje të madhe shpirtërore. Në tërë ato vite punë nuk kisha shkëmbyer asnjë fjalë me askënd, ndërsa ata më nxorën në komision përballë 13*



*kolegëve nga të gjitha fakultetet, megjithëse as kjo djallëzi nuk ju eci. Rezultati ishte 8-2 në favorin tim.*

*- 29 Mars 2022 Dekani doli me urdhër duke shkruar një sektor 70 vjecar, duke lëvizur profesorët e duke i ndryshuar ngarkesën si kurrë me parë dhe në kundërshtim me çdo rregullore apo statut duke më grabitur ngarkesën nëpërmjet heqjes së degëve në të cilat unë jepja mesim për dy dekada.*

*- Dhjetor 2023 dekani vendosi mospagimin e mbingarkesës së miratuar në departament në një kohë që pothuajse të gjithë kolegët e mi e kanë marrë.*

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ankuesja pranë Komisionerit, konstatohet se:

Ankuesi E. K, është pedagogje me titullin Dr., pranë Departamentit të Energjitikës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Në bazë të Urdhërit nr.41, datë 29.03.2022, me nr. 224 prot., datë 29.03.2022 të Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike "Për riorganizimin e mësimdhënies të lëndës "Vizatim Teknik dhe CAD", është urdhëruar ndër të tjera: Dr. E. K, mbetet pjesë e stafit akademik të Departamentit të Prodhim Manaxhimit në FIM. Departamentet në parashikim të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023 të përfshijnë personelin akademik të shtuar sipas këtij urdhëri, duke zbatuar Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë".

Rezulton se, në datën 04.04.2022, Urdhëri nr.41, datë 29.03.2022, me nr. 224 prot., datë 29.03.2022 i Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike "Për riorganizimin e mësimdhënies të lëndës "Vizatim Teknik dhe CAD", është kundërshtuar nga ankuesja E. K, M. Z dhe A. N.

Midis ankueses dhe FIM ka vijuar komunikimi në lidhje me këtë çështje dhe në vijim rezulton se, me shkresën 898/2 prot datë 13.05.2022, shkresën nr.1983 prot., datë 08.09.2022, ka kërkuar informacion në lidhje me e moskthimit përgjigje lidhur me ankesën për kundërshtimin e Urdhërit nr.41, datë 29.03.2022 të Dekanit të FIM.

Me shkresën nr.598/1 prot., datë 28.09.2022, ankuesja i është drejtuar Drejtuesit të Departamentit Dr. Ilo Bodi, me anë të cilës kërkon sqarim mbi parashikimin e ngarkesës për vitin akademik 2022-2023.

Me email e datës 08.05.2023 ankuesja i është drejtuar Senatit, me anë të cilit kërkon informacion në lidhje me ndryshimet strukturore të FIM, duke parashtruar dhe argumentat e saj. Korespondenca ka vijuar dhe me email të tjera në vijimësi, lidhur me ngarkesën mësimore të pedagoges E. K. etj..

Me shkresën nr. 734/1 prot., datë 15.12.2023 rezulton që ankuesja E. K, të ketë depozituar "Deklarimin e ngarkesës përfundimtare të realizuar nga personeli akademik efektiv për vitin akademik 2022-2023".

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 17, dt. 07.02.2024, duke pretenduar se është diskriminuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës, pasi në mënyrë të padrejtë i është hequr ngarkesa mësimore dhe i është mohuar e drejta për të përfituar pagesën e orëve suplementare.

- Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ....b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.<sup>3</sup> GJEDNJ, në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të

---

<sup>3</sup> Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë, prg. 90.

trajtosha ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma (neni 3, LMD), ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2 LMD) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7, LMD).

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Referuar parashtrimeve të bëra nga ankuesja në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, rezulton se, pretendimet e saj në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, nuk përfshihen në ndonjë prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga neni 1, i LMD-së. Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, ankuesi ka identifikuar në formularin e ankeses “çdo shkak tjetër”.

Ankuesja pretendon se, procedura që ndiqet në FIM në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore por dhe mënyra e pagesës së orëve suplementare jo vetëm që është e paligjshme dhe vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, por për vitin akademik 2022-2023, ajo është zbatuar në mënyrë diskriminuuese për ankuesen. Sipas ankueses, kolegët që e kanë marrë pagesën e orëve suplementare, nuk iu është kërkuar dokumentacion justifikues apo evidenca mbështetëse për aktivitetin e tyre, sikurse ka ndodhur me ankuesen, e cila edhe pse ka depozituar të gjithë dokumentacionin justifikues, nuk është paguar për orët suplementare. Ankuesja pretendon se, evidencat mbështetëse nuk janë kërkuar për të gjithë personelin akademik, por në mënyrë selektive vetëm për disa që nuk futen në “të preferuarit” apo “mbështetësit në vota”, ashtu siç e kanë kategorizuar ankuesen.

Në informacionin plotësues të depozituar në datën 23.02.2024, ankuesja shprehet se: *Në 2020 Z. Genti Guxho shpalli kandidaturën për pozicionin Dekan. Në mbledhjen e parë të fushatës ku Z.Genti Guxho na mblodhi për të shprehur kandidaturen në 2020, unë jam ngritur e para, (dëshmitarë janë të gjithë kolegët e mi), dhe e kam pyetur: “Ju Z. Genti Guxho keni qënë në ekipin drejtues të FIM dhe UPT për sa vite unë ju mbaj mend të jeni pedagog e të jemi kolegë bashkëmoshatarë, si ka mundësi që ju pjesë e udhëheqjes nuk e kishit kuptuar këtë korrupsion dhe drejtim të dhunshëm??? A nuk ishit edhe ju pjesë e vendimarrjes dhe favorizimeve në këto 16 vite?” Natyrisht nuk mora përgjigje, por mora etiketimin si “vota kundër”. Pyetja ime në hapjen e fushatës, pëlqimi që unë kam shprehur për kandidatin kundërshtar të tij Prof. F. B, profesori im, dhe mospranimi im për të diskutuar rreth votimeve me njerzit që ai dërgonte, si Prof. A. Sh, në etiketimin tim si “vota kundër”.*

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkak i mbrojtur. GJEDNJ-ja, në praktikën e saj ka theksuar se fjala “shkak/status tjetër” ka një kuptim i gjerë.<sup>4</sup> Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”<sup>5</sup>.

Bazuar në standartet e mësipërme si dhe pretendimet dhe provat e depozituara nga ankuesja në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se është diskriminuar “për çdo shkak tjetër” pasi nuk futet në “të preferuarit”, “mbështetësit në vota”), nuk përbën një shkak të mbrojtur nga diskriminimi sipas nenit 1, të LMD. Në arritjen e

<sup>4</sup> Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

<sup>5</sup> Shih: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

këtij përfundimi, Komisioneri merr në konsideratë edhe faktin që ankuesja nuk paraqiti asnjë provë për të provuar pretendimet e saj në lidhje me shkakun e diskriminimit.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, pretendime e ngritura nga pala ankuese në ankesën objekt shqyrtimi, në mungesë të shkakun të pretenduar të diskriminimit, nuk përfshihen në fushën e veprimit të LMD. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesja E. K, ka paraqitur kundër Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës, për sa kohë që ato nuk përbëjnë pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr.17 datë 07.02.2024, e paraqitur nga ankuesja E. K, kundër Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës Nr.17, datë 07.02.2024, të paraqitur nga ankuesja E. K, kundër Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Konceptoi: Laureta Jani, Inspektore DHA  
Miratoi: Vilfrida Bushati, Drejtore DHA  
Datë: 18.03.2024